Prishtinë, më 19 prill 2016

RAPORT ME REKOMANDIME

A.nr: 223/2015
Lavdim Mehmeti

A.nr: 229/2015
Xhevat Sadrijaj

A.nr: 65/2016
Nexhat Kastrati

kundër

Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Për: Z. Avni Jashari,
U.D. Zëvendës Drejtor Menaxhues – likuidim
Z. Shpend Maxhuni,
Drejtor i Policisë së Kosovës
Z. Aleksandër Lumezi,
Kryeprokuror i Shtetit

Lënda: Lirimi i pronave të ndërmarrjeve shoqërore të shitura nga Agjencia Kosovare e Privatizimit nga shfrytëzuesit e paligjshëm

Baza ligjore: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135, paragrafi 3
Ligji për Avokatin e Popullit, neni 18, paragrafi 1.2

Qëllimi i raportit

1. Qëllim i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë Shtetërore lidhur me uzurpimin e pronave të privatizuara nga shfrytëzuesit e paligjshëm.

Kompetenca e Avokatit të Popullit

2. Bazuar në nenin 18, paragrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 05/L-019, Avokati i Popullit ka përgjegjësi *"Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandime që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla."*

3. Po ashtu sipas nenit 18, paragrafi 1.7 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 05/L-019, Avokati i Popullit është i autorizuar *"të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës."*

Heqja dorë nga përgjegjësia

4. Asgjë nga përmbajtja e këtij raporti nuk duhet nënkuptuar si heqje dorë të Avokatit të Popullit nga e drejta e tij për të hetuar ankesat e individëve që pohojnë shkeljet e të drejtave të njeriut apo keqpërdorimet e pushtetit rreth çështjeve lidhur me ligjin dhe praktikën e lartpërmendur ose të shqyrtojë dekretet e ngjashme ligjore për pajtueshmërinë e tyre me standardet e njohura ndërkombëtare. Avokati i Popullit i rezervon të gjitha të drejtat për të ushtruar jurisdikcionin e tij lidhur me këto ose çështje tjera të ngjashme.

Përshkrimi i rastit

5. Ky raport është bazuar në ankesa të ndara të parashtruara nga z. Lavdim Mehmeti z. Xhevat Sadrijaj, dhe z. Nexhat Kastrati kundër AKP-së lidhur me uzurpimin e pronave të cilat ata i kanë blerë nga AKP-ja nëpërmjet procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore.

Rasti i z. Lavdim Mehmeti

6. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 15.1, të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195, më 30 prill 2015, ka pranuar ankesë nga z. Lavdim Mehmeti kundër AKP-së, në lidhje me lirimin e objektit N.SH. "Gërmia", Shitorja Nr.1, Lakrishte, Prishtinë, të cilin ankuesi e ka blerë nga AKP-ja sipas *Marrëveshjes për Shitblerjen dhe Bartjen e Pronës*, Nr.289/2011, të datës 11 tetor 2011.

7. Sipas pohimeve të ankuesit dhe dokumenteve të cilat ai i ka paraqitur te Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), ai edhe pse e ka kryer bartjen e pronës në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri, asnjëherë nuk ka mundur ta marrë pronën nën posedim faktik për shkak se prona si gjatë kohës së shitjes ashtu dhe deri më tani ka mbetur e uzurpuar nga shfrytëzuesit e paligjshëm. Fakti se prona ishte e uzurpuar në kohën e shitjes vërtetohet me Shtojcën 2 të *Marrëveshjes për Shitblerjen dhe Bartjen e Pronës* e cila në mënyrë eksplicite thekson se *"...kjo pronë është e uzurpuar dhe është përgjegjësi e blerësit të merret me të gjitha shpenzimet dhe rreziqet në lidhje me uzurpimet e objektit dhe t'i liroj ato."* Rrjedhimisht, më 8 dhjetor 2011, z. Mehmeti kishte paraqitur padi për lirimin e pronës në Gjykatën Themelore të Prishtinës (GJTHP), mirëpo ajo ende nuk ka vendosur lidhur me padinë.

Rasti i z. Xhevat Sadrijaj

8. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 15.1, të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195, më 30 prill 2015, ka pranuar ankesë nga z. Xhevat Sadrijaj kundër AKP-së, në lidhje me lirimin e objektit N.SH. "Rilindja", Shitorja Nr.3, Prishtinë.

9. Sipas pohimeve të ankuesit dhe dokumenteve të cilat ai i ka paraqitur në IAP, ankuesi është bërë pronar i pronës më 1 shkurt 2012. Deri në shitjen e pronës AKP-ja si administratore e pronës së ndërmarrjeve shoqërore e kishte lëshuar pronën me qira dhe me rastin e shitjes së saj e kishte njoftuar qiramarrësin për pronarin e ri. Z. Sadrijaj pohon se qiramarrësi ka refuzuar të lirojë pronën ose të vazhdojë kontratën e qiramarrjes me atë si pronar të ri. Z. Sadrijaj për më shumë pohon se AKP-ja nuk ka marrë përgjegjësi për lirimin e pronës prandaj ai më 13 mars 2013 ka paraqitur padi për lirimin e paluajtshmërisë pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës (GJTHP) por ajo nuk ka vendosur ende lidhur me padinë.

Rasti i z. Nexhat Kastrati

10. Sipas pohimeve të ankuesit ai më 13 gusht 2012 ka nënshkruar Marrëveshjen mbi Shitjen e Aksioneve të ndërmarrjes shoqërore "Trepça" objekti biznesor Restorant "Ylli" në Mitrovicë, me Drejtorin Menaxhues të AKP-së. Në kohën e shitjes së pronës, prona i ishte lëshuar me qira nga AKP-ja shfrytëzuesit aktual të pronës, i cili ka refuzuar ta lirojë pronën me pretekst se ai ka një kontratë për qiranë me AKP-në dhe se ka bërë investime në atë pronë. Sipas marrëveshjes AKP-ja nuk merr përgjegjësi për barrën që mund të ekzistojë mbi pronën dhe se është përgjegjësi e blerësit të merret me të gjitha shpenzimet dhe rreziqet në lidhje me uzurpimet e objektit dhe t'i liroj ato. Z. Kastrati ka paraqitur padi për lirimin e pronës së uzurpuar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë (GJTHM), për të cilën kishte vendosur gjyqtarja e EULEX-it. GJTHM ka aprovuar kërkesëpadinë e z. Kastrati mirëpo pala tjetër në procedurë, ka paraqitur ankesë dhe lënda që nga fundi i vitit 2013 ndodhet në Gjykatën e Apelit.

11. Z. Kastrati ka paraqitur ankesë në IAP në fazën përfundimtare të hetimeve lidhur me rastet e z. Mehmeti dhe z. Sadrijaj. Mirëpo, specifikat e ankesës së z. Kastrati janë të ngjashme me ato të ankesës së z. Sadrijaj, prandaj Avokati i Popullit e ka përfshirë rastin e Z. Kastrati në këtë raport.

Hezitimi i gjykatave për të vendosur lidhur me paditë civile për lirimin e pronave të uzurpuara

12. Avokati i Popullit vëren se nga Gjykata Themelore në Prishtinë ka hezitim për zgjidhjen e rasteve të z. Mehmeti dhe z. Sadrijaj. Ndërsa, në rastin e z. Kastrati hezitimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë ishte evident pasi që për rastin në shkallën e parë ka vendosur gjyqtarja e EULEX-it. Sipas Aktgjykimit të GJTHM C.nr.221/2012 i datës 12 dhjetor 2013, vihet në pah se Këshilli Gjyqësor i Kosovës kishte zhvilluar procedurë disiplinore kundër gjyqtarit vendor për shkak të vonesave procedurale, pa fajin e paditësit, z. Kastrati.

13. Sidoqoftë, Avokati i Popullit vë në pah se uzurpimi i paligjshëm i pronës është vepër penale e sanksionuar me nenin 332 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, nr.04/082, dhe në rastet konkrete Policia e Kosovës dhe prokuroritë përkatëse do të

duhej të ndërmerrnin hapa konkret para se rastet të procedoheshin në procedurë civile.[1]

Bashkëpunimi i AKP-së me Avokatin e Popullit

14. AP fillimisht kishte zhvilluar një takim me zyrtarët e AKP-së për të marrë informata lidhur me rastet. Gjatë takimit, AP ishte vënë në dijeni se AKP-ja më 21 nëntor 2014 kishte nxjerrë një vendim me numër reference 270/2014, sipas të cilit të gjitha asetet e ndërmarrjeve shoqërore të cilat janë në juridiksion të AKP-së do të lirohen nga posedimet e paligjshme dhe se lidhur me këtë më 10 dhjetor 2014 ka nxjerrë një *Udhëzues për Lirimin e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpuesit (Shfrytëzuesit e Paligjshëm)* i cili ka për qëllim krijimin e praktikave uniforme për Zyrat Rajonale të AKP-së me zbatimin e një procedure unike për lirimin e asteve të uzurpuara në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe njësitë organizative të AKP-së.

15. Avokati i Popullit më 4 nëntor 2015 i është drejtuar AKP-së, me dy letra të ndara lidhur me ankesat e z. Mehmeti dhe z. Sadrijaj, me ç 'rast ka kërkuar qartësim të juridiksionit të AKP-së për lirimin e pronave të uzurpuara dhe ka kërkuar informata lidhur me mundësinë e përfshirjes së pronave të blera nga z. Mehmeti dhe z. Sadrijaj në procesin e lirimit të aseteve të uzurpuara.

16. Më 19 nëntor 2015, AKP-ja i është përgjigjur kërkesave të Avokatit të Popullit dhe ka njoftuar se shitjet e pronave kanë qenë të mbështetura me dokumentacion relevant përmes të cilit AKP-ja në atë kohë i ka bërë publikisht të njohura dhe se të dhënat për lokalet e sipërpërmendura, duke theksuar shprehimisht se në kohën e shitjes lokalet ishin të uzurpuara, se AKP-ja nuk mban përgjegjësi për lirimin e objekteve dhe nuk do të mbahet përgjegjëse për çfarëdo detyrimi që mund të rrjedh në të ardhmen dhe se kjo është përfshirë edhe në kontratën e nënshkruar me vullnet të lirë nga palët. Sidoqoftë, AKP-ja në përgjigjet e saj ka cekur se mbetet e përkushtuar që kërkesat e z. Mehmeti dhe z. Sadrijaj, do t'i paraqiten pa vonesë Bordit të Drejtorëve të AKP-së, pas funksionalizimit të tij[2], për udhëzim veprimi në këto raste, për shkak se vendimi i 21 nëntorit 2015 për lirimin e aseteve nga uzurpimi dhe posedimet e paligjshme nuk ka veprim retroaktiv.

Analiza Ligjore

17. Avokati i Popullit vëren se kontratat e shitblerjes kanë hyrë në fuqi më 11 tetor 2011 (Lavdim Mehmeti me AKP-në), më 1 shkurt 2012 (Xhevat Sadrijaj me AKP-në) dhe më 13 gusht 2012 (Nexhat Kastrati me AKP-në), gjatë kohës kur në fuqi ishte Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës nr.45/81, 29/86 dhe 28/88). Edhe pse Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin nr.04/L-077 Për Marrëdhëniet Detyrimeve, i cili ka hyrë në fuqi më 16 qershor 2012, në rastet konkrete do të zbatohet ligji i mëparshëm për shkak se marrëdhënia e detyrimeve ka lindur në kohën kur ligj i mëparshëm ishte në fuqi.

18. Avokati i Popullit është në dijeni se Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit është një ligj specifik dhe se në situata të caktuara i përjashton dispozitat e disa ligjeve të tjera, por ky ligj nuk përmban dispozita që përjashtojnë ligjin për marrëdhëniet detyrimore. Kjo për shkak se edhe vetë *Marrëveshja për Shitblerjen dhe Bartjen e*

[1] Shih nenin 14 të Ligji nr. 03/l-006 për Procedurën kontestimore: "*Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor.*"

[2] Avokati i Popullit më 30 tetor 2015 ka publikuar Raport me Rekomandime për Kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin, duke kërkuar propozimin dhe emërimin sa më të shpejtë të Bordit të Drejtorëve të AKP-së.

Pronës në nenin 7.8 të saj përcakton se kjo marrëveshje do të udhëhiqet dhe interpretohet në përputhje ligjin në fuqi. Pastaj fakti se palët janë udhëzuar t'i drejtohen gjykatës së rregullt kompetente dhe jo Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme vërteton se për marrëveshjet në fjalë zbatohet *Ligji për marrëdhëniet detyrimore.*

19. Kontratat në mes të AKP-së dhe ankuesve janë kontrata të dyanshme detyruese ku secili kontraktues mban përgjegjësitë për të metat materiale dhe juridike të përmbushje të kontratës. Neni 121, paragrafi 2 i Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës nr.45/81, 29/86 dhe 28/88) përcakton se: *"Kontraktuesi përgjigjet edhe për të metat juridike të përmbushjes dhe ka për detyrë ta mbrojë palën tjetër nga të drejtat dhe kërkesat e personave të tretë me të cilat e drejta e saj do të përjashtohej ose kufizohej."*

20. Përgjegjësia për të metat juridike të sendit (eviksioni) ekziston në rastet e shqetësimit të blerësit nga persona të tretë, për shkak të pretendimit të tyre se kanë të drejtën e pronësisë mbi sendin ose sendi është i ngarkuar me ndonjë të drejtë, siç është, p.sh., e drejta e servitudës, e pengut, e hipotekës apo ndonjë ngarkesë tjetër, e cila ka ekzistuar para se blerësi ta blinte atë send. Kërkesat e personave të tretë më së shpeshti shfaqen me marrjen e posedimit të sendit.[3] Që të ekzistojë përgjegjësia për të metat juridike, duhet të plotësohen këto kushte: që e meta juridike të ketë ekzistuar në momentin e lidhjes së kontratës, që blerësi të mos ketë ditur për një të metë të tillë dhe shitësi të jetë njoftuar me kohë për shqetësimin juridik nga ana e blerësit.[4]

21. AKP-ja ka pohuar, madje e ka përfshirë në marrëveshje faktin se blerësit kanë qenë të njoftuar se prona është e uzurpuar, prandaj sipas kësaj del se nuk plotësohet kushti i dytë për t'u konstatuar përgjegjësia për të metat juridike. Mirëpo, Avokati i Popullit konsideron se shitja e ndërmarrjeve shoqërore është një proces më i ndërlikuar i shitjes së pronave i përcaktuar me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, prandaj AKP-ja do të mund të ketë qenë në pozitë më të favorshme si administratore e pronës në shitje se sa blerësit, duke përfshirë kështu në marrëveshje dispozitat të cilat e përjashtojnë atë nga përgjegjësitë për të metat juridike. Mirëpo, palët me kontratë mund ta kufizojnë ose ta përjashtojnë përgjegjësinë për të metat juridike të sendit, përveçse kur shitësi ka ditur për ekzistimin e mungesave të tilla (theks i shtuar) ose e shfrytëzon pozitën monopolistike dhe në rast të kontraktimit të një klauzole të tillë, ajo nuk do të ketë efekt juridik, përkatësisht do të jetë nule.[5]

22. Avokati Popullit vëren se në rastin e z. Lavdim Mehmeti prona ka qenë e uzurpuar edhe kur AKP-ja ka qenë administratore e pronës, ndërsa në rastin e z. Xhevat Sadrijaj dhe ne rastin e z. Nexhat Kastrati prona ishte lëshuar me qira nga AKP-ja dhe se me rastin e shitjes nga AKP-ja qiramarrësit nuk e kishin liruar pronën dhe as nuk kanë pranuar të hyjnë në kontratë për qiranë me pronarët e rinj, me ç'rast ata nga pozita e qiramarrësit janë shndërruar në shfrytëzues të paligjshëm të pronave të privatizuara. Pa dyshim se në të tri situatat kemi të bëjmë me uzurpim të paligjshëm të pronës.

[3] Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Botimi i tretë, Prishtinë 2008; E Drejta e Detyrimeve, Mr.Sc. Rifat Zylfiu, fq.585.
[4] Po aty, fq.585
[5] Po aty, fq.586

E drejta për mbrojtje të pronës

23. Neni 46 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës parasheh:

    1. "E drejta e pronës është e garantuar" [...].

24. Neni 1 i Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)

    "Çdo person fizik apo juridik ka të drejtën të gëzojë në mënyrë paqësore zotërimet e tij. Askush nuk do të privohet nga zotërimet e veta përveçse në interes të publikut dhe kur është subjekt i kushteve të përcaktuara me ligj e sipas parimeve të përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare."

25. Lidhur me mbrojtjen e të drejtës pronësore Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në rastin Nr.K1187/13 N. Jovanoviq kundër Agjencisë Kosovare të Pronës, të cilës e drejta pronësore i është konfirmuar nga Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK), por ajo nuk ka mundur të hyj në posedim për shkak të uzurpimit të pronës nga persona të paautorizuar, ka konstatuar se: "*vendimi i KKPK-së, përbente pritje legjitime për parashtruesen, me te cilin është konstatuar se e njëjta është pronare legjitime e asaj prone. Prandaj, parashtruesja ka të drejtë ta gëzojë në mënyrë paqësore atë pronë, ashtu si garantohet me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës. Në këto rrethana, asaj i është mohuar e drejta e gëzimit dhe posedimit të pronës (shih, mutatis mutandis, Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke (dec. nr. 39794/98, para 73, GJEDNJ 2002-VII).*"

26. Në rastin e ankuesve në IAP janë *Marrëveshjet për Shitblerjen dhe Bartjen e Pronës* por edhe regjistrimi i të drejtës pronësore në Regjistrin e Paluajtshmërive që kanë krijuar pritje legjitime lidhur me pronat të cilat ata i kanë blerë nga AKP-ja.

27. Prandaj Avokati i Popullit konstaton se është cenuar e drejta pronësore e z. Mehmeti z. Sadrijaj dhe z. Kastrati.

Barazia para ligjit

28. Neni 3, paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës parasheh se:

    "Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuara ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe të pjesëtareve të tyre.

29. Avokati i Popullit përshëndet nxjerrjen e Vendimit nr. 270/2014 dhe *Udhëzuesit për Lirimin e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpuesit (Shfrytëzuesit e Paligjshëm)* që vlen për pronat që aktualisht janë nën juridiksionin e AKP-së dhe veprimet që AKP-ja i ka ndërmarrë për lirimin e pronave që janë në shitje. Kjo garanton se të gjitha pronat që do të shiten në të ardhmen do të lirohen nga shfrytëzuesit e kundërligjshëm dhe inkurajon AKP-në që të vazhdojë këtë proces në bashkëpunim me Policinë e Kosovës.

30. Mirëpo, Avokati i Popullit konsideron që vendimi nr. 270/2014 duhet të plotësohet dhe se juridiksione i AKP-së për lirimin e pronave të uzurpuara të zgjerohet edhe për pronat të cilat janë shitur para se vendimi të hyj në fuqi, përkatësisht për pronat e shitura para datës 21 nëntor 2014, duke u mbështetur në faktin se sipas analizës ligjore të mësipërme AKP-ja nuk mund të përjashtohet nga përgjegjësia për të metat juridike të përmbushjes.

31. Avokati i Popullit, konsideron se vendimi nr.270/2014 i cili aktualisht vlen vetëm për pronat që janë nën juridiksionin e AKP-së cenon barazinë para ligjit. Kjo për arsye se shitja e pronave është bërë në pajtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe se për të gjithë blerësit janë zbatuar procedura të njëjta të shitjes, prandaj edhe rezultati i shitjes së pronës do të duhej po ashtu të jetë i njëjtë për të gjithë blerësit.

32. Avokati i Popullit dëshiron të vejë në pah edhe nenin 2, paragrafin 3 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit i cili parasheh se :

"Ky ligj do të zbatohet në përputhje me parimet e parashtruara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj."

33. Prandaj, Avokati i Popullit konsideron se edhe lista e uzurpatorëve të pronave shoqërore do të duhej të zgjerohej për të gjitha pronat e uzurpuara prej vitit 1999.

Detyrimet dhe autorizimet e Policisë së Kosovës

34. Neni 10 i Ligjit nr. 04/l-076 për Policinë, përcakton detyrimet dhe autorizimet e Policisë së Kosovës. Sipas nenit 10, paragrafi 1 të ligjit, detyrat e përgjithshme të policisë janë, në mes tjerash, të mbrojë jetën, pronën dhe të ofrojë siguri për të gjithë personat (pika 1 e paragrafit 1); të mbrojë të drejtat dhe liritë themelore të të gjithë personave (pika 2 e paragrafit 1); të hetojë veprat penale dhe kryesit e tyre (pika 5 e paragrafit 1).

35. Avokati i Popullit konstaton se ankuesit nëpërmes punëve juridike të vlefshme si bazë juridike dhe regjistrimit në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri[6] janë bërë posedues të të drejtave mbi pronat e uzurpuara, se mbrojtja e pronës është një e drejtë themelore,[7] dhe se uzurpimi i pronës është vepër penale.[8]

Në bazë të kësaj që u tha më lart, si dhe duke u nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë dhe me qëllim të përmirësimit dhe rritjes së efikasitetit të autoriteteve, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135 paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe nenit 18 paragrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit:

Rrjedhimisht, Avokati i Popullit

Rekomandon që:

1. ***Agjencia Kosovare e Privatizimit të plotësojë vendimin nr. 270/2014 të datës 21 nëntor 2014 edhe për pronat për të cilat Agjencia ka përgjegjësi për të metat juridike të përmbushjes, të cilat janë shitur para datës 21 nëntor 2014.***
2. ***Policia e Kosovës të veprojë në bazë të detyrave dhe autorizimeve të përgjithshme të përcaktuara me nenin 10, paragrafi 1, pika 1, pika 2 dhe pika 5, të Ligjit nr. 04/l-076 për Policinë dhe të procedojë rastet e uzurpimit të pronave të privatizuara pranë***

[6] Shih nenin 36, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/l-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore

[7] Shih nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Nenin 1 të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)

[8] Shih nenin 332 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, nr.04/082.

prokurorive publike përkatëse në pajtim me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale;

3. ***Prokuroritë Publike të fillojnë procedurën penale kundër uzurpuesve të pronave të privatizuara në pajtim me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale.***

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartpërmendura.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin, Ju lutem që përgjigjen tuaj, lidhur me këtë çështje, ta dërgoni brenda një afati të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se deri më **20 maj 2016**.

Me nderime,
Hilmi Jashari
Avokat i Popullit